



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel:038/20043814

**KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY  
ISTOG**

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **21.10.2020** (e Mërkurë), në salën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                          |                           |
|--------------------------|---------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;     | 13.Nexhmedin Balaj, AAK;  |
| 2. Zenel Shatri, LDK;    | 14. Misin Berisha, AAK;   |
| 3. Besa Ferati, LDK;     | 15. Eliot Kukiqi, AAK;    |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;   | 16. Arditë Idrizaj, AAK;  |
| 5. Njomza Demaj, LDK;    | 17. Jehonë Haxhijaj,AAK;  |
| 6. Haki Podrimaj, LDK;   | 18. Labinot Aliaj, PDK;   |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK;     |
| 8. Riza Dreshaj, LDK;    | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 9. Ruzhdi Metaj, LDK;    | 21. Agron Avdijaj, VV;    |
| 10. Valbona Demaj, LDK;  | 22. Lavdije Bujupaj, VV;  |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK; | 23.Radoš Repanović, SL;   |
| 12. Naim Imeraj, AAK;    |                           |

Në mbledhje të ishin të pranishëm edhe Nënkyetari, Agim Ademaj, drejtore të drejtive të komunës, zyrtarë komunal, dhe media (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe gjendet në Youtube bashkëngjitur keni linkun (<https://www.youtube.com/watch?v=TMRUsTzgVJ8>)

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti të pranishmit, hapi punimet për mbledhjen e jashtëzakonshme, të Legjislacionit të VI-të bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, statutin e komunës dhe kërkesën e Kryetarit të Komunës. Dihet së në mbledhjet e jashtëzakonshme sipas rregullores dhe ligjit është një pikë e rendit të ditës ku diskutohet dhe debatohet lidhur me aprovimin apo mos aprovimin e saj.

### Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rialokimit dhe Transferit të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.

Në mbledhje munguan 4 (katër) këshilltarë: Arif Elshani, Arben Kabashi, Radenko Belošević dhe Slaviša Maliković.

#### Shqyrtimi i pikës së rendit të ditës.

**Kryesuesi**, a ka dikush diçka në lidhje me këtë? Urdhëro Radenko.

**Radoš Repanović**, Radosh, Radosh, mësoheni në mandatin tjetër, vetëm deshta të sqarohemi me një qeshje teknike, nuk e kemi pranuar materialin e përkthyer, kjo po ndodh në disa muajt e fundit, kjo nuk do të thotë që ne e bojkotojmë këto mbledhje të qeverisjes së paaftë, neve po na vinë vetëm ftesat, e jo materiali komplet.

**Kryesuesi**, a e keni dërguar përkthimin Vjosa?

**Vjosa Hysenaj**, po ju është dërguar edhe anëtarëve edhe Vesnes.

**Kryesuesi**, materialin e përkthyer? Diku ka mbetur, më duket e kanë përcjellë në adresën e Vesnes, nuk e di a janë konsultuar me të, dy tre muajt e fundit jam i sigurt që nuk është ashtu. Mirë do të shohim pas takimit ku është problemi dhe ku ka ngelë çështja.

Pyes anëtarët e Kuvendit kush është që të vazhdojmë punën me këtë pikë të rendit të ditës, kush është për?

**Konstatojmë se në mënyrë unanime anëtarët e Kuvendit miratuan pikën e rendit të ditës**

Momentalisht në sallë jemi 22 anëtarë, nëse nuk ka ardhur dikush ndërkohë.

Lidhur me pikën e rendit të ditës unë ftoj drejtorin për Buxhet dhe Financa, të raporton dhe sqaron lidhur me kërkesën për këtë pikë të rendit të ditës.  
Urdhëro i nderuari z. Hysni Maxharraj e ka fjalën!

Radoš Repanović, largohet nga mbledhja pas miratimit të rendit të ditës.

**Hysni Maxharraj**, faleminderit z. Kryesues! Përshëndet të gjithë të pranishmit!  
Prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Rialokimit dhe Transferit të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale'.  
Nuk po ju marrë më shumë kohë, nëse keni pyetje jam në dispozicion që të sqarojmë, faleminderit që më dëgjuat!

**Kryesuesi**, faleminderit drejtor! Materialin e kanë pasur është e vërtetë. Nëse ka dikush diçka lidhur me këtë pikë të rendit të ditës un ja përcjellë fjalën.  
Është lajmëruar Naim Imeraj!

**Naim Imeraj**, faleminderit për fjalën kryesues! Përshëndet të gjithë të pranishmit!  
Drejtori i drejtoratit sqaroi se të gjitha janë mbetje nga kontratat, edhe është përpjekje që kjo shumë siç u tha prej 98 mijë e 45 eurove të mos shkojë në suficit. Shpresojë se do të arrihet që kjo të realizohet përkundër afateve të ngushta. Në shkoqitje të këtij materiali kisha dashtë me i bërë disa pyetje që janë të natyrës teknike si zakonisht. Te rialokimi i parë bujqësi-bujqësi hapja e rrugëve malore Studenicë Lugu i Mahallës duke i ju referuar raportit të tre mujorshit të dytë, ky projekt nuk del me këtë kod, edhe kisha dashtë me i ditë rrethanat në të cilat e ka kodin 72583 për shkak se në tre mujorshin e dytë nuk ka qenë fare me këtë kod, pra ka qenë me kodin 47291 pa financim, së paku nga burimi 10. Çështja tjetër është te transferet, transferi i parë nga bujqësia e tutje në shërbime publike që ka të bëj me projektin 'Kubëzimi i trotuarit Banjë -Lubovë' na paraqitet një kod i cili prapë në raportin e tre mujorshit të dytë të buxhetit ky kod paraqitet me një emërtim tjetër, kështu që konsiderojë që duhet të sqarohet si është situata, kodi 47796 paraqitet me emërtimin e eliminimit e mbeturinave nga hapësirat publike, kështu që besojë se është një rrëshqitje teknike. Edhe te transferi i katërt, nga Zyra Komunale për Komunitete tek inspektimet projekti e ka një emërtim që shkon pak më gjatë se sa kjo që është dhënë këtu, Largimi dhe demolimi i objekteve të papërdorshme. Kaq kisha kryesues, shpresojë që kjo punë që po e bëjmë sot do të rezultojë në raportin përfundimtar vjetor suksesshëm.

**Kryesuesi**, faleminderit Naim! Fjalën e ka drejtori Hysni Maxharraj.

**Hysni Maxharraj**, po është fakt se projekti 'Hapja e Rrugës Malore Studenicë Lugu i Mahallës ka qenë në dy projekte. D.m.th. numrin e projektit që e përmendi Naimi prej grantit po ai ka përfunduar. Por e kemi edhe projektin me participim të qytetarëve që janë bartë mjetet nga viti i kaluar në këtë vit, d.m.th projekti është me numër 72583 Hapja e Rrugës Malore Studenicë Lugu i Mahallës që kanë participuar qytetarët në vlerë prej 7.000,00€ nuk kemi mundur me i përdor dy kodet për ata e kemi përdor këtë kodin që është në këtë vit d.m.th prej participimeve. D.m.th shkon në këtë kod. Te pyetja tjetër fakt është një lëshim teknik sepse 'Kubëzimi i trotuarit' dhe 'Eliminimi i mbeturinave', kanë qenë afër është bërë një ndërrim i këtij kodi, nuk do të jetë ai po është kodi 47787 që do ta përmirësojmë në shkresë dhe vendim. Dhe pyetja e fundit është 'Transferi i mjeteve nga ZLK-ja' fakt është ne gjithmonë kemi potencuar që kur të bëhen projektet duhet të jenë deri në 50 shkronja sepse nuk evidentohen, dhe unë e kam parë dhe nuk kam dashur të ndërrojë asgjë prej Free Balance d.m.th është ashtu, po është fjalë deri te lumi i Istogut, pra deri atje vazhdon.

**Naim Imeraj**, ku merren mjetet?

**Hysni Maxharraj**, aty veç nuk ka hapësirë në raportet e free balance-it

**Kryesuesi**, besojë që Naim u qartësuat. Dikush tjetër a e dëshiron fjalën?  
Agron Avdijaj është lajmëruar.

**Agron Avdijaj**, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë desha veç një lloj komenti me e dhënë lidhur me këto transferet dhe rialokimet e mjeteve, ndoshta me bërë përpjekje në të ardhmen që kur të bëhet planifikimi i projekteve të bëhet pak më i saktë në mënyrë që shuma e rialokimeve të jetë më e vogël d.m.th që të mos përsëriten vazhdimisht shumat e tillë, d.m.th t'i kushtohet më shumë rëndësi planifikimit më të saktë detaj, edhe shumat e projekteve në mënyrë që mos të ka nevojë me shkuar kësisoj. Përndryshe janë duke u transferuar edhe në projekte ekzistuese unë jam për.

**Kryesuesi**, faleminderit Agron!  
Është lajmëruar Arditë Idrizaj.

**Ardita Idrizaj**, përshëndetet të gjithë të pranishmit! Desha me pyet te mirëmbajtja e rrugëve malore verore-dimërore me kodin e projektit 50260 me shumë 8.000,00€. A ka

hyrë në këtë projekt 'Ndërtimi i kanalit anësor në lagjen 'Idrizaj' në Lubozhdë, sepse kodi nuk është i njëjtë.

**Naim Imeraj**, me na i pas dërguar vendimet kishte qenë më mirë, na keni premtuar me na i dërguar vendimet, ka mbetur zyra përkatëse pa i dërguar vendimet, e dini që herën e kaluar kërkoj falje që po flas kështu por ka qenë një që na keni dërguar Rialokimin që e kemi bërë në minutë të fundit, vendimet nuk na kanë ardhur.

**Kryesuesi**, drejtor a mundesh me shikuar, nëse ka ndonjë lëshim teknik është mirë me i përmirësuar këto.

**Hysni Maxharraj**, projekti mirëmbajtja e rrugëve malore verore-dimërore e ka kodin 50260 edhe në listën e projekteve kapitale në tabelën 4.2 d.m.th edhe në shkresë edhe në vendim është po i njëjtë kod. E sa i përket pyetjes për betonim të kanalit mundet me u përgjigji Enveri, Drejtori i Shërbimeve Publike, se ka të bëj fjalë me mirëmbajtjen verore-dimërore të rrugëve, jo të rrugëve malore. Këtu qëndron dallimi.

**Kryesuesi**, Hysni faleminderit! Drejtori Enver a mundesh me e plotësuar pak.

**Enver Rugova**, përvendoset të gjithë të pranishmit! Vendimi i mbledhjes së kaluar është pika tre që ka marrë vendim që obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Gatishmëri Emergjente që sa më parë të fillojë procedurat për 'Ndërtimin e kanalit anësor në lagjen 'Idrizaj' në Lubozhdë. Ndërtimi i këtij kanali do të bëhet nga projekti 'Mirëmbajtja verore -dimërore e rrugëve lokale, d.m.th kjo pritet tash, ne jemi në bisedime me kompani, duhet me e bërë një para masë sektori i shërbimeve publike, edhe 'Kompania DL' e rregullon këtë, d.m.th është vendim i Kuvendit nga mbledhja e kaluar. Projekti është prej Mallra dhe Shërbime nuk ka ndonjë telashe aty e rregullojmë. Faleminderit!

**Kryesuesi**, dikush tjetër nga anëtarët e Kuvendit a e dëshiron fjalën?

Nuk është lajmëruar askush, atëherë të nderuar anëtarë të Kuvendit duke u konstatuar se në sallë jemi nëse nuk po gabojë unë le të më përcjell Sekretaria e Kuvendit jemi 22 anëtarë të Kuvendit. Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Kush është për?

**Konstatojmë se në mënyrë unanim miratohet pika e rendit të ditës i paraparë për takimin e sotëm 'Shqyrimi dhe miratimi i Rialokimit dhe Transferit të mjeteve në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale.**

Pra ky propozim miratohet, i urojmë sukses ekzekutivit në veçanti drejtorit të buxhetit që t'i realizojë sa më mirë këto mjete. Ju faleminderit për pjesëmarrje ju urojë ditë të mbarë!

Mbledhja përfundoi me punë në orën 10:30.

Procesmbajtëse,  
zpj. Flora Bujupaj



Kryesuesi i Kuvendit,  
z. Qaush Balaj

